

Dimensioni human dhe Mishngrënësit e mëdhenj

Sot në botë flitet dhe ka studime mbi mishngrënësit e mëdhenj. Karnivorë të mëdhenj konsiderohen Ariu (*Ursus arctos*), Ujku (*Canis lupus*), Rrëqebulli (*Lynx lynx*), të pranishëm edhe në Shqipëri.



Lynx lynx (Rrëqebulli)

Në shumë vende (Francë, Zvicër, Amerika e Veriut) janë bërë studime për sa i përket mishngrënësve të mëdhenj, por në një tjetër këndvështrim, atë të studimit të raportit të humanëve me ta.

Duke marr shkas nga këto studime dhe kryesisht nga gjendja e mishngrënësve të mëdhenj në Shqipëri ne kemi vendosur të studiojmë në kuadër të një projekti, pozicionin tonë si qenie njerëzore në lidhje me mishngrënësit e mëdhenj.

A janë ata armiq dëmtues apo thjesht specie , të cilat ndoshta kërkojnë më tepër vëmendje nga ne...

Në këtë projekt bashkohen Organizatat ndërkombëtare Grupi Specialist i Maceve të Egra të Botës (IUCN SSC/Cat Specialist Group), Organizata Zvicerane për Menaxhimin e Mishngrënësve të Mëdhenj (KORA), Fondi Evropian për Trashëgiminë Natyrore (Euronatur) dhe Instituti Norvegjez për Kërkimet Mjedisore (NINA), dhe shoqatat implementuese të projektit; Shoqata për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA), Shoqata për Ruajtjen e Shpendëve dhe Gjitarëve të Shqipërisë (ASPB) dhe Shoqata Ekologjike Maqedonase (MES), ku vëmendja kryesore i është drejtuar rrëqebullit të Ballkanit (mishngrënës i madh më i rrezikuar, për Shqipërinë mendohet të ketë vetëm 25 individë).

Ndër objektivat më kryesore të këtij bashkëpunimi përmendim studimin dhe monitorimin e species, pozicionin e njerëzve ndaj mishngrënësve të mëdhenj, shpalljen e zonave të mbrojtura etj.

Duke u bazuar mbi këto objektiva duket qartë se dimensionin human luan një rol të konsiderueshëm në menaxhimin e Jetës së egër.

E gjitha kjo përfshin jo vetëm të kuptuarit e biologjisë dhe habitatit të species, por edhe qëndrimin publik ndaj tyre e njohuritë mbi speciet dhe gjithashtu qëndrimin ndaj një menaxhimi të mundshëm drejtuar species.

Dimensioni human për menaxhimin e jetës së egër është veçanërisht i rëndësishëm për të kuptuar projektimin dhe implementimin e një plani menaxhimi për mishngrënësit e mëdhenj,

të cilët shpesh herë shkaktojnë konflikte midis publikut të gjerë. Kështu menaxhimi i Karnivorëve të mëdhenj është shpesh më tepër çështje politiko – sociale sesa biologjike.

Këto aspekte humane është e nevojshme të kuptohen nëpërmjet një procesi shkencor dhe objektiv për konservimin e mishngrënësve të mëdhenj në Shqipëri.

Dimensioni human fokusohet në nivelin e njohurive publike, qëndrimin dhe aktivitetin ndaj mishngrënësve dhe habitateve shoqëruese të tyre.

Një nga synimet që tenton të përmbushë çështja e dimensionit human është identifikimi i llojit të konfliktit ndërmjet mishngrënësve të mëdhenj dhe humanëve. Në këtë mënyrë do të jemi në gjendje të hartojmë planet e zgjidhjes së këtyre konflikteve.

Për këtë ne kemi plotësuar pyetësorë , të cilët përmbajnë pjesën e pyetjeve për sa u përket konflikteve. Janë përzgjedhur gjithsej 66 fshatra të Shqipërisë , ku këto specie janë të pranishëm dhe deri tani janë vizituar 32 (pjesa tjetër do të vizitohet gjatë 2 viteve të tjera pune në projekt).

Në këto fshatra (pjesa kufitare me Maqedoninë) janë intervistuar 70 persona (gjuetarë, bari, punonjës pyjesh, individë me njohuri të mira për zonën).

Nga pyetësorët është parë se ka pasur dy lloje kryesore dëmtimesh nga Mishngrënësit e mëdhenj; dëme në njerëz dhe dëme në të mbjella, pemë frutore, bagëti, koshere bletësh etj.

Dëmet në njerëz kanë qenë të pakta dhe përbëjnë 22% të fshatrave të vizituara; të tilla ka pasur në Sopot, Strarvaj, Fushë-Stude, Peshkopi / Dibër (më 2005 nga ujku), Selishtë (nga ariu dhe ujku), Kala e Dodës (më 2001 dhe 2005 nga ariu), Rapdisht- Bellovë (më 1999- 2000 nga ariu). Megjithatë këto raste që përbëjnë një pakicë, të intervistuarit pohojnë se sulme të tilla kanë ndodhur në rrethana të caktuara dhe se mishngrënësit e mëdhenj nuk përbëjnë një rrezik të mundshëm për njerëzit.

Dëmet në të mbjella, pemë frutore, bagëti, koshere bletësh etj. ka pasur në 78% të fshatrave të vizituara deri tani. Këto kanë ndodhur kryesisht në fshatrat Steblevë, Qarrishtë, Vithkuq, Gorçmenj, Vermosh, Vukël, Selcë, Goricë e madhe, Goricë e vogël, Voskopojë, Rrajcë, Gjerbës, Selishtë, Kala e Dodës etj.

Dëmet në të mbjella, pemë frutore, bagëti, koshere bletësh etj. ka pasur në 78% të fshatrave të vizituara deri tani. Këto kanë ndodhur kryesisht në fshatrat Steblevë, Qarrishtë, Vithkuq, Gorçmenj, Vermosh, Vukël, Selcë, Goricë e madhe, Goricë e vogël, Voskopojë, Rrajcë, Gjerbës, Selishtë, Kala e Dodës etj.



Ursus arctos (Ariu i murrmë)

Në pamje të parë duket se karnivorët e mëdhenj shkaktojnë dëme të mëdha, por në fakt dëme të tilla konsiderohen si të evitueshëm, në mënyrë që të ruajmë ekuilibra të shëndoshë natyrorë. Gjithashtu qëndrimi negativ i njerëzve ndaj natyrës është paraprijës i të gjitha këtyre dukurive.

Pyetjes se si mbrohen njerëzit nga mishngrënësit e mëdhenj shumica e të intervistuarve iu përgjigj se mbrojtja kryesore ishin armët. Atëherë duket qartë se më të rrezikshëm jemi në vend që të ishim mbrojtësit kryesorë të kafshëve...

Mishngrënësit e mëdhenj mbrohen me ligj (Konventa e Ruajtjes së Jetës së Egër dhe Habiteteve natyrore Evropiane- Konventa e Bernës), por mesa duket kjo mbrojtje tek ne ekziston vetëm teorikisht...

Tjetër faktor që dëshmon ndikimin negativ të njerëzve ndaj mishngrënësve të mëdhenj është gjuetia e paligjshme, e cila bashkë me faktorë të tjerë si degradimi i habitatit, pakësimi i ushqimit (sërisht ndikimi i njeriut) bëjnë të mundur pakësimin e specieve dhe jo vetëm kaq, por këto të fundit mund të cilësohen edhe si shkaku kryesor i dëmtimeve që kanë ndodhur nga karnivorët e mëdhenj.

Nga studimi i deritanishëm në intervalin kohor 1991 – 2006 janë vrarë 33 Arinj; në intervalin kohor 1980 – 2005 janë vrarë 12 Rrëqebuj dhe në intervalin kohor 1999 – 2006 janë vrarë 38 ujçer (nga këta 19 individë janë vrarë vetëm në 2006);

Siç shihet ne po shkatërrojmë hap pas hapi jetën e egër dhe po çorientojmë çdo ekuilibër ekzistues

Përse të mos u krijojmë mishngrënësve të mëdhenj habitatin e tyre të përshtatshëm në vend që të shtojmë shifrat marramendëse të vrasjes së tyre... A nuk do të ishte më mirë që të kishim një natyrë të pasur se sa një natyrë të varfër dhe pa jetë...

Ne nuk na mbetet gjë tjetër veçse në 2 vitet e ardhshme në kuadër të këtij projekti të punojmë për një publik të informuar dhe të ndërgjegjësuar e sigurisht të punojmë për një mirë menaxhim të jetës së egër , në mënyrë që ne dhe mishngrënësit e mëdhenj të bashkekzistojmë në harmoni të plotë...

Erjola Keçi - (ASPB)



canus- lupus